



NR 880/6 PROT
14.09.2018



Vjellin, Ganti
Rogneri, Sullu
14.09.2018
CUT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 1988 / prot.
3

Tiranë, më 13.09.2018

Lënda: Përcillet për zbatim shkresa nr. 1988 / prot, datë 13.09.2018 e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

FAKULTETIT TË MJEKËSISË
FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE ✓

Këtu


Në vijim për transferim studimesh në vitin akademik 2018-2019 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur ju përcjellim për zbatim shkresën nr. 1988 / prot, datë 13.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



REKTORI

Arben GJATA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 9314/1 Prot.

Tiranë, më 13.09.2018

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Arben GJATA
Rektor
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

TIRANË

I nderuar Z. Gjata,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1988/1 prot., datë 11.09.2018, me lëndë "Kërkesë për interpretim ligjor", Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ju bën me dije si më poshtë vijon:

Në nenin 89, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", parashikohet shprehimisht se:

"1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

"..4. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik".

Ligji parashikon se mbi bazën e kërkesës për transferim, lejohet transferimi i studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion.

Në shkresën tuaj përcaktohet se, ndalohet transferimi i studentëve brenda institucionit sipas statutit aktual, në fuqi të UMT-së, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik datë 07.06.2013, dispozitë e cila konsiderojmë se vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.80/2015 dhe për rrjedhojë nuk duhet zbatuar në respektim të paragrafit të dytë të nenit 142, deri në hartimin dhe miratimin e statutit të UMT-së në ministrinë përgjegjëse për arsimin, sipas ligjit nr.80/2015.

Lidhur me afatet e procedurave të transferimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018-2019", i ndryshuar, sqarojmë se kërkesat e studentëve duhet të rivendosen në afat, duke shtyrë të gjitha afatet procedurale me 5 ditë, në zbatim të nenit 54 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", pasi janë penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afateve procedurale të përcaktuara në udhëzimin e sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

